



Datë: 02.02.2026
Numër Protokolli: 591/2026

A.nr.1991/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Flakron Gashi-në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1991/2025 të datës 05.12.2025 të parashtruar nga ankuesi F.B, nga Leposaviqi, kundër Vendimit të datës 20.11.2025 të Komisioni Disiplinor të Komunës së Leposaviqit, në çështjen juridike *“Ndërprerje e Marrëdhënies së Punës”*, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 02.02.2026, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet** si e bazuar ankesa A.nr.1991/2025, e datës 05.12.2025 e parashtruar nga ankuesi F.B.
- II. Anulohet** Vendimi Nr.2950, i datës 20.11.2025 i Komisionit Disiplinor të Komunës së Leposaviqit.
- III. Obligohet** Kryetari i Komunës së Leposaviqit që të kujdeset për bëjë zbatimin e këtij vendimi në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi, ashtu që ankuesin duhet të kthejë në vendin e tij të punës, sipas Akt të Emërimit nr.1431 të datës 03.10.2024, duke ia kompensuar pagat e paguara dhe atë në mënyrë retroaktive, nga dita e ekzekutimit të masës disiplinore e deri në zbatimin e këtij vendimi.
- IV.** Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Nëpunësi Civil, F.B (*tani e tutje referuar vetëm: Ankuesi*), më datë 05.12.2025 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është regjistruar nën shenjën A.nr.1991/2025, kundër Vendimit të datës 20.11.2025 të Komisioni Disiplinor të Komunës së Leposaviqit, përmes të cilit akt, ankuesit i është shqiptuar masa disiplinore “*Largim nga Shërbimi Civil*”.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 23.12.2025, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën tek Komuna e Leposaviqit, ndërsa, kjo e fundit, më datë 26.12.2025, ka dorëzuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kryetari i Këshillit, me datë 14.01.2026 ka nxjerrë Vendimin me shifër VK/2025 dhe numër protokolli:147/2026, përmes të cilit ankesës së ankuesit nën shenjën A.nr.1991/2025 të datës 05.12.2025 ia ka vazhduara afatin e vendimmarrjes edhe për dhjetë (10) ditë të tjera, ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesën e datës 05.12.2025 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin e datës 20.11.2025 të Komisionit Disiplinor; Akt Emërimit të datës 03.10.2024; Kopjen e ID-së së ankuesit; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 23.12.2025; Përgjigje në kërkesë e datës 26.12.2025; Shkresën sqaruese Nr.prot:3109 të datës 26.12.2025 të Njësisë së Burimeve Njerëzore; Vendimin e datës 14.01.2026 të Kryetarit të Këshillit.

Kolegji i Këshillit pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e parashtruara të lëndës nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankuesit është **e bazuar**, sepse:

Nga administrimi i provave të lëndës, Kolegji i Këshillit, ka konstatuar se ankuesi sipas Aktit të Emërimit të datës 03.10.2024 është i punësuar në pozitën *Zyrtar për Teknologji Informative* në Komunën e Leposaviqit, ndërsa Komisioni Disiplinor i organit të punësimit përmes Vendimit Nr.2950/2025 të datës 20.11.2025, ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore “*largim nga shërbimi publik*” me arsyetimin se i njëjti ka kryer shkelje të rënda të detyrave të punës për shkak të mos paraqitjes në punë, neglizhencës së vazhdueshme të përmbushjes së detyrave të punës , dhe braktisja e punës ose mungesa e paarsyeshme dhe e vazhdueshme për më shumë se tre (3) ditë pune, sikurse përcaktohet me dispozitat nga neni 56 pika 4.2 dhe 4.10 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshill ndaj aktit të kontestuar, pretendon se Vendimi i datës 20.11.2025 i Komisionit Disiplinor është nxjerrë duke shkelur esencialisht dispozitat procedurale nga neni 59 paragrafi 5, neni 60 paragrafi 3 i Ligjit nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik dhe nenit 47 paragrafi 1, nën paragrafi 1.3 dhe 1.4 dhe nenit 48 i Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe zbatim të gabuar të drejtës materiale si dhe konstatim gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me kërkesën që Këshilli të aprovoi ankesën e ankuesit, të anuloi aktin e kontestuar si dhe të obligoi organin e punësimit që ankuesin në vendin e tij të punës, më kërkesën që t’i kompensohen pagat e papaguara në mënyrë retroaktive dhe atë që nga data 21.11.2025, me arsyetimin se vendimi për ndërprerjen e marrëdhënies së punës ka qenë arbitrar, ankuesi nuk është njoftuar për hapjen e procedurës disiplinore si dhe masa e shqiptuar disiplinore nuk mbështet në asnjë provë të vetme.

Kolegji i Këshillit pas analizimit të aktit të kontestuar, konstatoi se Komisioni Disiplinor i Komunës së Leposaviqit me rastin e shqiptimit të masës disiplinore ndaj ankuesit përmes vendimit të datës 20.11.2025, lidhur me iniciimin e procedurës disiplinore i është referuar kërkesës së Kryetarit të Komunës, mirëpo nuk përmban të dhëna të tjera sqaruese rreth datës së parashtruar apo përmbajtjes së kërkesës në fjalë, ndërsa në arsyetimin e aktit në fjalë, përcaktohet se, citoj: “... në bazë të kërkesave për fillimin e procedurës disiplinore kemi kuptuar se i njëjti ka bërë shkelje të Ligjit për Zyrtarët Publik, nenin 56 pika 4.2, pra ka rezultuar se nga zyrtari publik ka pasur neglizhencë të vazhdueshme të përmbushjes së detyrave të punës e përveç kësaj i njëjti në kundërshtim me par.4.10 të po të njëjtit nen ka munguar për më shumë se 3 ditë në punë pa arsye dhe mungesën apo prezencën e tij i njëjti ka dështuar ta përmbushë”, mirëpo në asnjë pjesë të arsyetimit të vetëm Komisioni Disiplinor nuk iu referohet se cilat prova ka marr për bazë me qëllim të konstatimit të plotë të gjendjes faktike, nëse palës i është dhënë mundësia të njihet me pretendimet e ngritura në kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore, apo cilat kane qenë pretendimet ankimore të palës ankuese në seancën e mbajtur të komisionit disiplinor, gjegjësisht arsyetimi në fjalë nuk përmbush parakushtet ligjore të përcaktuara si në nenin 48 të LPPA-së lidhur me shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi, shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave, bazën ligjore të vendimit dhe arsyen pse është e zbatueshme në rastin konkret, shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palëve, ashtu që një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij.

Thënë si më lartë, Kolegji i Këshillit përmes zyrtarit të autorizuar me rastin e dërgimit të kërkesës për përgjigje në ankesë te organi i punësimit me datë 23.12.2025, ndër tjerash kishte kërkuar provat si në vijim: “Vendimin për themelimin e Komisionit Disiplinor dhe akt emërimet e anëtarëve të komisionit përkatës; **Kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore; Dëshmitë mbi bazën e të cilave ankuesi është gjetur përgjegjës; Procesverbalet e seancave të Komisionit Disiplinor; Dëshmi me shkrim nëse ankuesi në të kaluarën ka pasur të shqiptuar masë disiplinore**”, kurse në përgjigjen e datës 26.12.2025, Drejtoresha e Administratës së Përgjithshme të Komunës së Leposaviqit, konfirmon faktin se me rastin e ndryshimit të kryetarit të Komunës dhe pas marrjes së detyrës të njëjtit nuk kanë gjetur asnjë dosje që ndërlidhet me rastin e ankuesit, përjashtimisht aktit të emërimit dhe Vendimit të Komisionit Disiplinor të datës 20.11.2025, pra mungojnë kërkesa për iniciimin e procedurës disiplinore, procesverbalet e seancës disiplinore si dhe dëshmitë mbi bazën e të cilave ankuesi është gjetur përgjegjës, dhe njëkohësisht e njëjta konfirmon faktin se Komuna e Leposaviqit nuk ka Njësia përgjegjëse të Burimeve Njerëzore, kurse paraprakisht këto detyra ka qenë duke i kryer Menaxheri i Komunës së Podujevës sipas marrëveshjes së datës 01.03.2024 ndërmjet Komunës së Leposaviqit dhe Komunës Podujevës.

Fillimisht Kolegji i Këshillit thekson faktin se pozita *Zyrtar për Teknologji Informative* të cilën e mban ankuesi sipas Akt të Emërimit të datës 03.10.2024 është pozitë e punës në Shërbimin Civil, pozitë kjo e përcaktuar edhe në Katalogun e Vendeve të Punës me shifër SHCK1470, nga rrjedh se Komisioni Disiplinor gabimisht iu ka referuar nenit 85 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, pasi që kjo dispozitë e trajton çështjen e përgjegjësisë disiplinore për nëpunësit e shërbimit publik, kategori tjetër kjo e zyrtarëve publik, sikurse përcaktohet në ligjin përkatës të zyrtarëve publik, bëhet dallimi ndërmjet këtyre dy kategorive në nenin 5 të të njëjtit ligj.

Me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji i Këshillit mori për bazë dispozitat e aplikuar nga nenin 60 paragrafi 11 të LZP-së ndërlidhur me nenin 13 paragrafi 1, 2, 3, 4 dhe 6 të Rregullores Nr.01/2024 Për Disiplinën e Nëpunësve Civil, ku përcaktohet se: “1. Komisioni fillon menjëherë shqyrtimin e fakteve dhe provave në procedurën disiplinore pas pranimit të kërkesës për

iniciu të procedurës disiplinore. 2. Komisioni vlerëson faktet dhe rrethanat e rastit që janë të nevojshme për marrjen e vendimit. 3. Komisioni kryen edhe këto veprime deri në marrjen e vendimit: 3.1. merr në pyetje ose merr deklaratë nga dëshmitarët dhe verifikon faktet; 3.2. shqyrton dokumentacionin përkatës; 3.3. mund të ftojë iniciuesin e procedurës disiplinore për t'u njohur me variantin e tij të rastit; 3.4. kryen çdo veprim tjetër të nevojshëm për verifikimin e ngjarjes. 4. Procedura administrative disiplinore garanton të drejtën e nëpunësit për t'u njoftuar lidhur me fillimin e procedurës, për t'u informuar lidhur me shkeljen faktike të pretenduar dhe provat për kryerjen e saj, të drejtën për t'u dëgjuar, për të paraqitur prova, të drejtën për të pasur qasje në dokumente që lidhen me procedurën, për mbrojtje juridike, të drejtën për t'u asistuar, si dhe të drejtën për t'u ankuar ndaj vendimit përfundimtar 5. Seancat e Komisionit janë të mbyllura, përpos nëse parashihet ndryshe me legjislacionin në fuqi dhe mbahen me praninë e të gjithë anëtarëve. 6. Procedura dhe vendimmarrja zhvillohet në përputhje me ligjin përkatës për procedurën administrative”, prandaj duke marrë për bazë dispozitat e aplikuara si më lartë, përmbajtjes së arsyetimit të aktit të kontestuar si dhe përgjigjes së dhënë të datës 26.12.2025 nga organi i punësimit, Kolegji i Këshillit arriti në konstatimin se Komisioni Disiplinor me rastin e nxjerrjes së Vendimit të datës 20.11.2025 dhe për rrjedhojë shqiptimit të masës disiplinore largim nga vendi i tij i punës, ka vepruar në kundërshtim të plotë me dispozitat e aplikuara të ligjit material të përcaktuar si në rregulloren përkatëse, dhe nenin 8 paragrafi 1, dhe nenit 61 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik ndërlidhur me nenin 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ngase në rrethanat e rastit konkret Komisioni Disiplinor nuk ka vepruar sipas përgjegjësisë ligjore, gjegjësisht të njëjtit vetëm se e kanë përshkruar masën disiplinore sipas kërkesës për iniciimin e procedurës disiplinore, konstatim ky mbi bazën e arsyetimit të dhënë si në aktin e kontestuar, respektivisht të njëjtit nuk e kanë ndërmarrë asnjë veprim juridik apo administrativ për shqyrtimin pretendimeve të ngritura nga iniciuesi i procedurës apo konstatimin e saktë të gjendjes faktike, dhe se nuk kanë arritur të administrojnë apo t'i referohen një prove të vetme mbi bazën e së cilës do të konfirmohej fakti se ankuesi është përgjegjës për shkeljen e pretenduar, madje nga akti i kontestuar nuk mund të arrihet në konstatimin se ankuesi është ftuar në seancë, respektivisht për Kolegjin e Këshillit arsyetimi i dhënë si në aktin e kontestuar nuk është bindës, pasi që është nxjerrë në shkelje esenciale të dispozitave të LPPA-së.

Thënë si më lartë, pas analizimit dhe shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit, konstatimit të gjendjes faktike si dhe duke marrë për bazë kuadrin ligjor në fuqi të cekur si më lartë, Kolegji i Këshillit konstatoi se procedura në fjalë, ishte përcjellë me shkelje procedurale dhe materiale sikurse përcaktohet me dispozitat e aplikuara nga nenit 52 paragrafi 1, nën paragrafi 1.3, 1.4 dhe 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: “52. Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1 është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative; 1.4. është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ; 1.5. është në kundërshtim me ligjin material” për arsyet e dhëna si më lartë në arsyetimin e këtij vendimi, andaj me qëllim të kthimit të ligjshmërisë në vend, ankesa e ankuesit është aprovuar si e bazuar në ligj, ndërsa në mbështetje të nenit 55 paragrafi 1 të LPPA-së, është anuluar Vendimi i datës 20.11.2025 i Komisionit Disiplinor të Komunës së Leposaviqit, sikurse u vendos në dispozitivin e këtij vendimi Prandaj, nga se u tha si më lartë, organi i punësimit, respektivisht kryetari i Komunës së Leposaviqit duhet të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme juridike me qëllim të zbatimit të këtij vendimi, duke e kthyer ankuesin në vendin e tij të punës “Zyrtar për teknologji Informative” sipas Aktit të Emërimit Nr.1431 të datës 03.10.2024, si dhe të njëjtit t'i kompensohen të gjitha pagat e papaguara në mënyrë retroaktive nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënies së punës e deri në momentin e zbatimit të këtij vendimi, ndërsa

po ashtu Kryetari i Komunës duhet të kujdeset sipas detyrës zyrtare për largimin e masës disiplinore nga dosja personale e ankuesit, pasi që Komunës së Leposaviqit i mungon Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nënin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, si dhe nënin 132 paragrafin 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij Vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda: A.nr.1991/2025, datë 02/02/2026

Flakron GASHI

Procesmbajtës

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit F.B;
- Komunës së Leposaviqit (Kryetarit të Komunës, Drejtoreshës së Administratës së Përgjithshme të Komunës dhe Njesisë së Burimeve Njerëzore), si dhe;
- Arkivit të KPMSHCK-së.